



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I DËGJIMIT PUBLIK NGA KOMISIONI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR EKONOMI, INDUSTRI, NDËRMARRËSI DHE TREGTI,
MBAJTUR MË 20 QERSHOR 2024**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA ZA
EKONOMIJU, INDUSTRIJU, PREDUZETNIŠTVO I TRGOVINU,
ODRŽANE 20. JUNA 2024. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2024**

Dëgjimin publik e drejtoi kryesuesja e Grupit punues, znj. Mimoza Kusari-Lila.

KRYESUESJA: Mirëdita të gjithëve, mirë se keni ardhur,

Të nderuar kolegë deputetë,

Deputet Hyseni, deputet Lekaj,

Të nderuar të pranishëm,

Përfaqësues të institucioneve, të organizatave të biznesit,

Ju uroj mirëseardhje në këtë dëgjim publik,

Mund të konstatojmë se janë plotësuar kushtet për fillimin e këtij dëgjimi publik, pasi që të gjithë që kanë konfirmuar ardhjen për ditën e sotme janë tashmë këtu.

1. Projektligji nr.08/L-295 për krypto-asetet

Të nderuar pjesëmarrës, siç e dini në bazë të nenit 38 dhe 39 të Rregullores së Punës së Kuvendit, komisioni organizon seancë dëgjimore për projektligje që janë në procedurë të shqyrtimit me përfaqësues të institucioneve publike, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit dhe qytetarë të interesuar. Para se të hyjmë në detaje, gjegjësisht në procedurën e këtij dëgjimi publik, më lejoni që shkurtimisht të ju informoj gjithashtu me procedurën e deritashme të shqyrtimit të ligjit, pasi që disa prej jush tashmë e dini se u bënë më shumë se dy vite që nisma nga deputetët e Komisionit për Ekonomi, për Projektligjin për krypto-asetet është filluar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Deri më tani, në këtë proces grupi i punës ka mbajtur dy dëgjime publike për këtë projektligj, do të thotë dy herë gjatë procesit të draftimit të projektligjit kemi pasur dëgjime të kësaj natyre. Dëgjimi i parë publik është mbajtur që në gusht të vitit 2021, për të diskutuar për idenë e projektligjit. Ndërsa, i dyti me një draft apo me një përmbajtje me kornizë të projektligjit është mbajtur një vit më pas apo në korrik të vitit 2022. Në mbështetjen e Këshillit të Evropës, zyrës në Prishtinë, grupi i punës ka mbajtur gjithashtu dy punëtori dy ditore, me datë 7 dhe 8 mars 2023, dhe 29 dhe 30 maj 2023.

Këshilli i Evropës përmes ekspertëve ka mbështetur grupin e punës për hartimin e këtij projektligji me këshilla në funksion të përafrimit të këtij projektligji me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë në fushë veprimtarinë e krypto-aseteve. Gjithashtu fokusi nga ana e ekspertëve të Këshillit të Evropës ishte të punojmë kundër pastrimit të parave nëpërmes biznesit me krypto-asete. Në diskutimi të grupit punues në këto punëtori kanë marrë pjesë përfaqësues nga Njësia e Inteligjencës Financiare, nga Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Ministria e Financave, Doganat, ARKEP-it, odat ekonomike dhe subjektet tjera.

Ajo çfarë ka qenë diskutabile në vazhdimësi në fakt në këtë proces kanë qenë institucionet përgjegjëse. Do të thotë, prej idesë fillestare që ne do angazhojmë ose mund të angazhojmë apo të hapim një njësi të veçantë në kuadër të ARKEP-it kemi lëvizur që funksionet mbi rregullimin,

menaxhimin, mbikëqyrjen e tregut të kriptoseteve të jenë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në kuadër të dëgjimit publik, ne zakonisht takohemi për mbledhjen e informacioneve, vërejtjeve, rekomandimeve për projektligjin dhe çështjet tjera që janë në procedurë të shqyrtimit nga komisioni. Në frymën e kësaj dispozite, si dhe duke marrë parasysh që si Parlament dhe komision parlamentar jemi të hapur dhe transparent në çështjet që shqyrtojnë, si kryesuese e grupit punues kemi caktuar këtë dëgjim publik.

Tani është faza e parë para se grupi punues të shqyrtojë nën për nen projektligjin. Do të thotë, jemi të interesuar të marrim nga ju, të nderuar pjesëmarrës, opinionet, propozimet, rekomandimet lidhur me projektligjin që tashmë në formatin si është para jush ka kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Republikës. Shkurtimisht një përmbledhje, cilat janë synimet e projektligjit. Ky ligj në momentin e miratimit në dy leximet ka për qëllim të rregullojë: licencimin, autorizimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve që ushtrojnë veprimtari të ndërlidhur me emitimin, shpërndarjen, tregtimin dhe ruajtjen e kriptoseteve.

Pastaj, kushtet e operimit dhe organizimit të operatorëve në fushën e emitimit, tregtimit dhe ruajtjes së kriptoseteve. Kushtet dhe kriteret për transparencë gjatë emitimit dhe tregtimit të kriptoseteve në platforma tregtare. Rregullat për mbrojtjen e konsumatorëve lidhur me shërbimet e operatorëve për emitimin, tregtimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe shërbimet e konsulencës lidhur me kriptosetet.

Sanksionet në rastin e praktikave abuzive, si dhe çështjet tjera që lidhen me shërbimet në fushën e teknologjisë së regjistrave të shpërndarë. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Evropian 2023/1114 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës, me 31 maj 2023, mbi tregjet e kriptoseteve dhe ai që ndryshon rregulloret e Bashkimit Evropian, 1093/2010 dhe 1095/2010, direktiva 2013/36 dhe 2019/1937.

Tani pas kësaj pjesës hyrëse ju kaloj fjalën juve pjesëmarrës që të paraqitni opinionet tuaja për këtë projektligj, si dhe propozimet nëse keni të tilla. Si informatë teknike, ju lus edhe për shkak se kemi edhe media prezente në sallë që kur ta merrni fjalën të prezantoheni dhe të tregoni cilësinë në të cilën jeni apo institucionin që përfaqësoni. Faleminderit, për pjesëmarrjen tuaj dhe tashmë fjala është për ju.

ARIANIT DURAKU: Arianit Duraku nga kompania Kaktus. Unë kam vite ose dekadë që e ndjek tregun e kriptove... edhe më bëri përshtypje që the Banka Qendrore e Kosovës është institucioni rregullativ edhe kontrollor i kriptove. Në çfarë forme?

KRYESUESJA: Së pari ne kemi si Kuvend përgatitim legjislativ primar, gjegjësisht ligjin i cili paraqet parametrat kryesor të rregullimit të një sektori i cili në asnjë formë, ose në asnjë mënyrë nuk ka pas rregullativ. Do të thotë, prej procesit të emetimit, te ... që e dini që është ...

gjatë së cilës është dashtë me marr një veprim në kuadër, vetëm në elementin e furnizimit me energji apo konsumit të energjisë elektrike, po jo në rregullimin e vetë tregut të kripto aseteve si një industri e re. Tani në aspektin e vlerës, flasim për valutë, e cila valutë ka nevojë për organizim dhe mbikëqyrje e rregullim natyrisht të procedurave gjatë së cilës emitohet, tregtohet apo edhe në kuadër të krijimit të platformave të reja tregtare. Në krejt institucionet që ne kemi pasur gjatë periudhës së konsultimit nuk kemi mundur të gjejmë një përafrim më të madh se sa atë me Bankën Qendrore.

Tani Banka Qendrore në funksionin, në organogramin aktual si e ka, e ka më të vështirë ta vendosë diku, por duhet të krijohet një njësi në kuadër të Bankës Qendrore, e cila ekskluzivisht do ta ketë funksionin të marrjes me rregulloret pastaj, se vjen legjislacioni sekondar, Kuvendi e ka legjislacionin primar apo ligjin me të cilin pastaj Banka Qendrore fillon përgatitjen për licencim, rregullat tjera të cilat kanë të bëjnë me tregun e përgjithshëm të kripto aseteve. Banka Qendrore janë këtu, nëse dëshirojnë gjithashtu.

ELVIN MALA: Përshëndetje, kryesuese!

Shkurtimisht, vetëm kisha dashtë me ripotencue atë që Banka Qendrore tani do ta ketë rolin dhe përgjegjësinë për licencimin, autorizimin dhe monitorimin e të gjithë operatorëve ose këtyre që do të merren me kripto-asete.

Ne vetëm se kemi filluar diskutimet përbrenda Bankës Qendrore për organizimin edhe ndarjen e resurseve të nevojshme për zhvillimin e akteve nënligjore, të cilat do të vijnë pas miratimit të këtij ligji.

ARIANIT DURAKU: Folët më herët thatë për ndalimin e shpëlarjes së parave ose të gjitha mënyrave të tjera, të cilat janë jo ligjore. Në qoftë se Banka Qendrore është duke planifikuar një draft të tillë, në çfarë mënyre mundesh me monitorua diçka të tillë me e parandalua, duke e ditë se Kosova akoma nuk e ka legal tender bitkoinin.

KRYESUESJA: Sa i përket parandalimit të shpëlarjes së parave, ne e kemi pasur konsulencën direkte nga Këshilli i Evropës, gjegjësisht nga dy ekspertë nga Këshilli i Evropës, një nga Irlanda, një nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që kanë qenë siç e përmenda në dy punëtori dy ditore.

Në kuadër të kësaj pjesë me Këshillin e Evropës, gjegjësisht në ato punëtori kanë qenë edhe NJIF-i, gjegjësisht Njësia e Inteligjencës Financiare. Do të thotë, prejardhja e parasë, origjina e mjeteve të investuara, origjina e fitimit dhe ri investimi i tyre, të cilat mbesin subjekt të një institucioni të specializuar në kuadër të Republikës së Kosovës, në këtë rast NJIF-i dhe në rast se ka indikacione mbi abuzimin apo tendencën e futjes së parave, të cilat kanë prejardhje të

dyshimtë, apo të cilat janë fituar në mënyrë të jashtëligjshme atëherë janë organet kompetente. Në kuadër të kësaj dhe pjesa e sanksionimit pastaj i takojnë NJIF-it dhe Policisë së Kosovës.

Gjithashtu, zoti Duraku, deputeti Hyseni jep sugjerim që në rast se keni komente mbi përmbajtjen aktuale të projektligjit, ne në fund pasi të kryhen të gjithë komentuesit, gjegjësisht të gjithë të pranishmit të japin komentet e veta ju tregojmë që keni edhe një afat një javor për të dërguar me shkrim komentet tuaja në nenet aktuale që janë të projektligjit të miratuar në lexim të parë, për shkak se në mes të dy leximeve ndodhin ndryshimet apo mund të reflektohet mbi komentet e këtij dëgjimi publik.

ARIANIT DURAKU: Edhe një pyetje, meqenëse erdhëm te ky draftimi. Njerëzit që e kanë bërë draftimin sa e njohin bllok chain-in, sa e njohin botën e kriptos? Sepse për të ditë, për të marrë masa parandaluese ose masa zhvilluese duhet të jesh një person i cili ke shumë njohuri në mënyrën se si funksionon, si kontrollohet, si monitorohet dhe si zgjerohet.

KRYESUESJA: Tani ne në test nuk i kemi fut asnjërin në kuadër të asaj se sa kanë njohuri për block chain-in, megjithatë jeni të gjithë të vetëdijshëm që kjo është një teknologji e re, por gjithashtu edhe një sektor i ri i cili po gjeneron të hyra, po gjeneron aktivitet.

Dhe, si Kuvend i Republikës, bazike ka qenë për ne që të fillojmë me prezantimin e normativës ligjore për krijimin e një rendi të themi legjislativ apo ligjor mbi këtë veprimtari. A e kemi bërë më të mirën ose a është idealja, me siguri që keni hapësirë dhe mundësi për ta plotësuar apo për të shtuar e natyrisht edhe me i inkuadrua të tjerët, në funksion të saj është edhe ky dëgjim publik. Për atë ju thashë në rast se keni komente konkrete në raport me dispozitat e këtij projektligji ju lutem na dërgoni ose na thoni këtu, se kështu në njëfarë forme në pyetje testuese ose të kësaj natyre nuk po di as se cili është synimi ose cilës pjesë po i aludoni. Ok, atëherë është çështje tjetër, atëherë ju lus mundësisht ta lexoni, ta shihni a kemi pas a s'kemi pas njohuri për këtë dhe mandej natyrisht mundemi me diskutua e kemi edhe një javë kohë për këtë punë.

Deputeti Lekaj e kërkoi fjalën. Faleminderit!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar të pranishëm,

Sa i përket pyetjes që e bëre ndoshta ki të drejtë meqë Kosova është fillestare në këtë drejtim dhe sa i përket kripto asetëve apo kripto valutave, janë globale dhe ne duhet patjetër që të komunikojmë dhe t'i standardizojmë edhe ligjet, edhe rregulloret në fjalë.

Kur jemi te paraja apo paraja digjitale ta quaj këtu, kripto asetet, ne duhet që të kemi një licencim të tyre, duhet që të kemi një kontroll të tyre dhe unë nuk mendoj që ka ndonjë kompetencë dikush tjetër përpos Bankës Qendrore të Kosovës, sepse ajo e monitoron sistemin bankar, i

monitoron transaksionet edhe i licencon edhe sistemin bankar edhe bankat, por në këtë rrafsh edhe kripto asetet. Ndoshta keni të drejtë kur a e shihni ndonjë risk nga kjo për transparencë, për mbrojtje të të dhënave, për librin që duhet të krijohet që të regjistrohen të gjithë individët që kanë të bëjnë me këto, por shteti si shtet, qeveria si qeveri duhet që të ketë monitorim të parasë dhe duhet t'i monitorojë që këto të mos bëhen në mënyrë ilegale, të mos ketë shpëlarje të kësaj natyre dhe mos të financohet terrorizmi.

Prandaj, ne kur të kemi një atë që e përmendët block chain, duhet që të krijohet një libër, po e quaj "libër" që të regjistrohen tërë masa individëve apo individët që kanë të bëjnë me asetet dhe të mbrohen të dhënat, por edhe të monitorohen transaksionet. Janë individë, jo e kemi pa edhe në ligj po ndoshta nuk e keni lexuar në tërësi, por unë mendoj që sa më parë që të miratohet një ligj i tillë, sepse ne dimë dhe këtu jetojmë, dimë që ka qytetarë që merren me kripto asete dhe shumica prej tyre as që tatimohen. Prandaj një licencë tani mund të bësh pyetje për sa vjet do të jetë licenca, si do t'i qasemi, si do të ketë, çfarë sistemi që t'i obligojë qytetarët meqë është po e them globale dhe a janë të përshtatshëm ky ligj që të standardizohet me shtetet tjera që veç e kanë të aprovuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! A ka dikush tjetër? Po, urdhëro!

VIRTYT IBRAHIMAGA: Ju faleminderit për ftesën!

Faleminderit edhe për fjalën, unë kam qenë në fakt pjesë e grupit fillestar punues dhe ne e kemi bërë një draft asokohe, ky draft bazohet në atë draft mirëpo e kam vërejt se është varfëruar pak nga ai drafti paraprak sa i përket përmbajtjes edhe sa i përket sferës rregullative.

Unë nuk mendoj se kjo është shumë e dobishme, por në parim do të thotë mundet me u konsideruar se është në rregull edhe ashtu, por ndoshta është mirë me elaboruar pak se për çfarë arsye e konsideroj se ishte dashtë do të thotë me u mbajt disa procedura që janë paraparë në draftin paraprak me qenë edhe në këtë draftin e tanishëm. Drafti paraprak ka paraparë dispozita mjaftë të detajuara sa i përket autorizimit, licencimit.

Pra, janë paraparë dispozitat dhe kushtet, se në cilat raste dhe operatorët cilat kushte duhet me i përmbush për me e marrë një autorizim dhe me e marrë një licencë. Mandej, janë paraparë edhe kushtet tjera, sa gjatë do të jetë licenca, janë paraparë edhe kushtet e revokimit të licencës, pra kriteret që janë shumë me rëndësi për transparencën, kriteret që janë shumë me rëndësi edhe për investitorët që duan të vijnë këtu, se ata duan të dinë pak a shumë se cilat janë kriteret e autorizimit dhe operimit.

Tash, meqenëse ato janë larguar, ato duhen me u rregullua me akte nënligjore. Pra, prapë duhen me u rregullua, mirëpo me akte nënligjore pastaj reduktohet ajo transparenca. Trendi është edhe këtu në legjislacionin e Kosovës, që aktet administrative do të thotë draftohen në mënyrë shumë

burokratike dhe e ngrenë nivelin e burokracisë për të marrë autorizime, ose licenca për operim. Kështu që, unë e konsideroj që është e panevojshme që janë larguar ato dhe nëse e konsideroni që është e dobishme, sikurse unë, atëherë ndoshta kishte me qenë mirë me i kthye.

Pastaj, është bërë një ndryshim te autorizimet dhe licencat. Tash, drafti paraprak e ka paraparë që të gjitha operimet që kanë të bëjnë me tregtim të kalojnë në autorizime. Pse? Sepse, ashtu është euro-trendi në EU, do të thotë shtetet evropiane, gjithashtu edhe Komisioni Evropian, do me e ulë barrierën e operimit të operatorëve. Këtë e ka bërë edhe këtu agjencioni që merret me telekomunikacion, ARKEP-i. Do të thotë, prej licencave ka kaluar në autorizime, që është progres në fakt.

Disa tregtime, për shembull: tregtimi, ose ruajtja e portofolios, kanë kaluar në licenca. Në rregull, nuk është ndoshta edhe problematike me kalua në licenca, por unë nuk e shoh si trend progresiv. Do të thotë, përderisa ne i kemi në ligj të përcaktuara kriteret për ta marrë një autorizim për tregtim, pse të kalohet në licencë tash?

Për shembull, Banka Qendrore është e specializuar në dhënien e licencave, mirëpo gjithashtu realiteti na tregon që procedura për marrjen e licencës pranë Bankës Qendrore është mjaft e gjatë dhe ndoshta e kushtueshme për dikë. Tash, ndoshta është mirë me mendua a mundemi diçka që nuk ka nevojë domosdoshmërisht me u trajtua prej Bankës Qendrore me licencë, të trajtohet me autorizim. Unë mendoj që në draftin paraprak bartja e krejt tregtimit në autorizime dhe jo licencime ka qenë e dobishme, mirëpo natyrisht se ju e konsideroni, ose e vlerësoni se është ashtu më mirë, apo jo.

Çka ka ndodhur me emetimin tash, kjo është një çështje mjaft diskutabile këtu. Për shembull, emetimi, licencat e emetimit, kanë kaluar në autorizime, por në fakt emetimi është ajo që krijon vlerën e një tokeni. Do të thotë, bash ajo duhet me kalua në licencim. Nëse flasim për parandalimin e shpëlarjes së parave, atëherë aty është fokusi, se emetimi e krijon një aset dhe është shumë me rëndësi me e ditë a është ai aset real, apo nuk është aset real dhe aty duhet me u ngritë kriteret e licencimit, se aty është vlera, nuk është vlera te tregtimi, te tregtimi është vlera e shtuar.

Kështu që, do të thotë se unë mendoj që nuk është e duhur që ka kaluar pjesa e emetimit në autorizime. Emetimi duhet të kalojë në licencë, sepse i nënshtrohet procedurave se si emetohet, janë ato kriteret që janë në librat e bardhë për atë punë se qysh duhet me u krijuar një aset, qysh duhet me u tregtue, masandej qysh duhet me u dhënë në treg edhe ato kriteret që janë të përcaktuara në librin e bardhë ato e bëjnë vlerën reale të asetit dhe ato e parandalojnë krijimin e aseteve fiktivë, që mandej ruhen.

Kështu që, mendoj se duhet me u kthye. Mirëpo, tash e kemi në këtë projekt gjithashtu ku ne flasim se ky rregullon emetimin, por në fakt nuk e rregullon emetimin, se dispozitat për emetim nuk janë më. Tash, këtu ky ligj, nëse është për krypto-asete dhe nëse nuk i ka dispozitat e parapara për emetim, atëherë detyrimisht duhet në fakt me e ndërrua emrin dhe me qenë, me u quajt “ligji për tregtimin e krypto-aseteve”. Pra, unë e shoh të mangët këtu, se nuk... dispozitat për emetim nuk po i gjej. Është për shembull, ajo dispozita për emetim është çështje kryesore në këtë lëmi edhe pa dispozita për emetim nuk ka krypto-aset.

Çka e shoh ndoshta si deficit, po unë e kuptoj që kemi pasur edhe atëherë diskutimin, do të thotë këtu nuk e kemi më licencën e OFUS-it për shërbime inovative. Në fakt, ne kemi diskutuar shumë gjatë në atë kohë, nëse duhet me e krijuar një bazë, që në fakt me u zhvillua branzha, do të thotë me u zhvillua tokenët, se ajo e sjell zhvillimin. Mirëpo, unë mund ta kuptoj që ne ndoshta edhe nuk jemi aq larg që me e zhvillua këtë teknologji, edhe pse nëse ne e krijojmë një infrastrukturë ligjore, ne mundemi me i sjellë njerëzit, ose operatorët e jashtëm, të cilët më pastaj investojnë në shërbimin, në krijimin e tokenëve, se krijimi i tokenëve nuk kufizohet në përdorimin e krypto-aseteve, po e zhvillon krejt teknologjinë, edhe natyrisht e zhvillon reformën administrative shtetërore, duke kaluar prej një procedure me letra, në një procedurë digjitale. Mirëpo, do të thotë kjo nuk është në fakt defekt i këtij ligji, se nuk e shoh si defekt, kishte me qenë vlerë shtesë dhe mundem me e kuptua që mos të jetë pjesë e këtij ligji, por nuk mundem disi të rehatohem me atë që ky ligj të mos e rregullojë emetimin e krypto-aseteve.

Në përgjithësi, sido që të jetë dhe sido që shkon, unë mendoj që më mirë është me pas diçka, se kurrëgjë, po nëse mundemi edhe diçka me bë, ndoshta kishte me qenë mirë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, Virtyt!

Po! Është e vërtetë se ne prej fillimit kemi qenë në bashkëpunim në lidhje me përgatitjen e draftit të parë. Megjithatë, çka kemi konkludua pas një drafti që kemi nxjerrë, është se ka pasur tepër shumë rregullim. Domethënë, prej një mungese të një rregullimi të çfarëdoshëm, menjëherë në rregullim të detajeve e në disa raste edhe kosto birokratike më shumë se sa është vlerësuar që mundet me pas një stimulim, në kuptimin e investimit dhe qarkullimit në këtë teknologji të re, të themi financiare, që lidhet me paranë digjitale.

Sidoqoftë, unë pajtohem që ka hapësirë për përmirësim. Unë e thash edhe në fillim, që nuk është ky drafti i parë që është miratuar në Kuvend, që është hap përpara, dhe i cili... kështu që me qenë të gjithë në të njëjtën faqe në rajon ende nuk ka më të detajuar, kështu që edhe analogjia e shtetit tonë me vendet e rajonit me aspirata të njëjta ka qenë pak problematike, se është vetëm një ligj bazik shumë bazik në Shqipëri, i cili nuk ka shkuar as në këto detaje të cilat projektligji i Kosovës i ka, e para. Dhe e dyta, që kemi qenë midis dy sfidave, që një njëfarë forme e kanë prodhuar edhe këtë draft që është para jush.

Edhe e para ka qenë, se si me u sigurua që ka një rregullim të një industrie të re, që nxitë investimet, teknologjinë inovative, fitimin, por natyrisht edhe obligimet ndaj shtetit dhe në anën tjetër, si me e parandalua po të njëjtën që të mos krijohet një mekanizëm i shpëlarjes së parasë, sikurse ka ndodhur në disa vende, ose mos me e pas mundësinë që me u bë një hap këtu në Kosovë e parasë së fituar jashtëligjshëm për me u pastrua këtu.

Dhe, midis këtyre të dyjave edhe e kemi... për atë ka zgjatur procesi. Në ndërkohë kemi pasur edhe rregullativën e Bashkimit Evropian, që prapë është gjeneralë, nuk ka shumë detaje, por u është lënë më shumë shteteve sipas specifikave të veta ta rregullojnë.

Unë nga krejt ajo çfarë ti përmende, mundem me u pajtua që te pjesa e emetimit keni hapësirë te plotësimi, për arsye se po, është e vërtetë, është aktiviteti i rëndësisë së veçantë te rasti i kriptoseteve para se me ndodhë tregtimi pastaj edhe shkëmbimi në platforma, për çka në rast se ne këtu flasim për nenin 6 dhe nenin 8, ku përmenden. Nëse ke propozime konkrete, siç e thash edhe më herët, mundesh me i dorëzua, se ne pastaj kur i hyjmë nen për nen mundemi me shikua mënyrën se si e kemi mundësinë me reflektua në plotësim.

Sa i përket udhëzimit administrativ, ti e di, je jurist, po edhe të tjerët që janë këtu, si në Kuvend, si në ministri, apo agjenci të pavarura, secili udhëzim administrativ kalon nëpër procedurë edhe të konsultimit publik, njëjtë sikurse projektligjet. Nuk është faza e njëjtë, sepse nuk miratohet në Kuvend, por në situata të këtilla edhe BQK-ja ishte dashur ta dërgojë informatën te të gjithë aktorët relevantë për përcaktimin e kriterëve për autorizim, të cilat i janë lënë njësisë për faktin se kemi konsideruar se nëse përcaktohet çdo gjë në ligj, kemi me e ngarkua dhe se nuk e dimë ende se si ka me e pas funksionim të mirëfilltë projektligji. Po.

VIRTYT IBRAHIMAGA: Nëse ka mundësi?

Do të thotë, procedurat që janë të parapara atëherë me ligj, do të thotë ato natyrisht se kanë qenë të bazuara në diçka dhe kanë qenë në mënyrë komperative janë shikuar se si rregullohen në vendet tjera.

Tash, në qoftë se ju i largoni rregullativën prej ligjit, atëherë e zhvendosni në aktin administrativ. Ashtu ka bërë edhe Shqipëria në fakt, mirëpo gjashtë vite s'ka ndodhur asgjë me atë ligj, derisa s'janë nxjerrë aktet administrative. Do të thotë... edhe tash i kanë nxjerrë aktet administrative, po prapë nuk ka filluar të zbatohet ligji. Do të thotë, qëllimi nuk është i atyre dispozitave, nuk ka qenë që me e ngarkua ligjin, por ato janë dispozita të domosdoshme rregulluese, edhe për parandalimin e shpëlarjes së parave, të cilat në fakt janë përcaktuar me ligj në mënyrë transparente për secilin operator që do të vijë të investojë, në vend se me u zhvendosë tash përmes akteve administrative, për të cilat ndoshta duhet vite për t'u miratua e para miratimit të tyre ju nuk mundeni me e zbatua. Kur i keni në ligj, ai ligji mundet me u zbatua edhe pa to. Kjo ka qenë ideja. Faleminderit!

ARIANIT DURAKU: Te pika e tregtimit me licencë, ose jo, personalisht e shoh si një pikëpyetje të madhe për arsye se ka njerëz që janë individë që kanë portofoliot e veta në block chain, nëpër Exchange, edhe munden me të shitblerje dorë më dorë, pa kontroll, pa licencë, edhe në qoftë se mendojmë se mundet me pas një akt rregullativ në këtë pikë për monitorim, të paktën duke parë se eksperiencat e shteteve tjera që kanë bërë marrëveshje me Exchange të mëdha, shtet me Exchange është e vetmja mënyrë për të pasur monitorim të saktë, se kush tregton në Kosovë. Sepse, asnjë Exchange sot nuk lejon të tregtohet në qoftë se ti nuk je i verifikuar.

Të paktën unë mendoj se kjo është një pikë që duhet me qenë gurë themel për monitorim. Përndryshe, nuk ka monitorim. Jep licencë gjithë ditën, nuk ke si ia sheh transaksionet atij që ia ke dhënë licencën.

KRYESUESJA: Po më duket se po nisemi prej faktit aktual. Ne po flasim për një moment në të ardhmen, në të cilin pas miratimit të ligjit nuk është Banka Qendrore aty me qëndruar prej zyrës, me dalë e me i shikua kush është duke tregtuar, ose kush jo. Po flasim për inkuadrim me platformat në të cilat tregtohen kripto-asetet, e para dhe e dyta, flasim për rregullimin e qarkullimit të parasë edhe për Kosovë, për ata që... natyrisht se ka të tillë që munden me i mbajte në platforma ndërkombëtare dhe asnjëherë mos me i nxjerrë mjetet për me i shpenzua këtu. Por, në momentin kur i sjellin këtu, secili duhet me e ditë që duhet të ekzistojë një normë, në të cilën fitimi i sjellë në Kosovë për shtetas të Kosovës ekziston një dispozitë ligjore për të.

Domethënë, jemi duke folur në terme rregullatorë, të cilët kanë me e rregullua elementin financiar, por gjithashtu edhe për ngritje të kapacitetit brenda institucionit, në raport edhe me platformat ndërkombëtare. Nëse ka Banka Qendrore. Po.

ELVIN MALA: Po gjithsesi, kryesuese.

Fillimisht, më duhet me e ritheksua që ky ligj shumë mirë i përcakton dhe e bën ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, pra lojtarët kryesorë i përcakton.

Lidhur me aktet nënligjore, në këtë rast përgjegjësia për një pjesë të madhe i bie Bankës Qendrore të Kosovës. Besoj se është mënyra e duhur se ku dhe si të vendosen ato kriteret, ndoshta teknike, ose të gjitha ato tjerat që përcillen më pastaj.

Dhe, sa i përket monitorimit dhe mbikëqyrjes, Banka Qendrore e Kosovës ka aftësi, ka kapacitete dhe përvojë në mbikëqyrje të industrive të ngjashme, siç është Ministria Financiare. Kjo ndoshta është e re për ne, nuk mundem me thënë që kemi përvojë, mirëpo nuk është diçka që nuk mund të arrihet.

Edhe e fundit, besoj se Banka Qendrore e Kosovës gjithmonë ka qenë transparente, lidhur me të gjitha aktet nënligjore që i ka zhvilluar dhe i ka trajtuar, po edhe i ka ndarë me të gjithë akterët e interesit. Faleminderit!

KRYESUESJA: A ka dikush prej të pranishmëve shtesë diçka? E kam kërkesën për fjalë prej dy deputetëve, deputeti Lekaj dhe deputeti Hyseni.

PAL LEKAJ: Faleminderit!

Është e vërtetë që ndoshta në shikim të parë kur keni lexuar ligjin ka mangësi, por ne jemi këtu për të diskutuar dhe për të dhënë sugjerim, këshilla që nuk është dokument i vdekur dhe mund të ndryshojë.

Ne jemi këtu për të ndryshuar që jetë ligji më i implementueshëm, më i saktë dhe që të mos lë zbrazëti që në të ardhmen të keqpërdoret ky ligj apo dikush tjetër.

Ajo që mund të them, p.sh ky ligji e parasheh edhe licencat kur do të jenë, për cilat lloje administrative në nenin 5 i keni saktë të shkruara dhe po ashtu autorizimet që i ka neni 6. Do të thotë, a kemi ndonjë sugjerim që kjo të ndryshohet. Mund ta kemi një këshillë nga ju meqë jeni profesionist i fushës juridike dhe ne atëherë e diskutojmë dhe e qesim në ligj në nen.

Se draftimi, do të thotë, krejt këshilla bëhen që të nxjerrim një ligj të përshtatshëm. Sa i përket akteve juridike apo të ligjit. P.sh. ti nuk guxon që të nxjerrësh rregullore që nuk bazohet në këtë ligj apo akte nënligjore, sepse atëherë e shkelë.

Ne, çdoherë pas gjashtë muajsh shihet që nxjerrën aktet nënligjore që të jetë ligji i përdorshëm dhe i implementueshëm. Përndryshe, nuk besoj që dikush, a ministër, a dikush mund të dalë jashtë këtij ligji me akte nënligjore që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Nuk besoj, sepse atëherë me të vërtetë ne nuk e njohim mirë fushën juridike dhe i shkelim të drejtat e ligjit dhe atyre që është miratuar ligji. Aktet nënligjore, jam që ligji të bëhet i përdorshëm dhe të implementohet me nene të caktuar dhe të sqarohen nenet saktë. Me këtë atëherë mund edhe ato i qesi në diskutim publik dhe jepni këshillat tuaja. Kaq. Faleminderit!

DRITON HYSENI: Faleminderit, kryesuese, deputet Kusari!

Shumë të nderuar të pranishëm, edhe unë si anëtar i këtij grupi pune, ju falënderoj shumë për gatishmërinë që sot të jeni prezentë dhe të jepni komentet tuaja lidhur me këtë projektligj, i cili e ka marrë miratimin në lexim të parë nga seanca e Kuvendit më datë 23 maj të këtij viti.

Sigurish që këto dëgjime publike i organizojmë me qëllimin e vetëm që të marrim sa më shumë komente edhe këndvështrime edhe nga palët edhe nga operatorët, nga kushdo që është i

interesuar për projektligje të cilat Kuvendi i ka në trajtim e sipër, për arsye se kështu e plotësojmë edhe e pasurojmë ligjin edhe sigurisht që e sigurojmë edhe një efektshmëri më të madhe të ligjit, kur ai veç aprovohet edhe në lexim të dytë.

E tha edhe zoti Lekaj, vet ligji përcakton që në një afat prej 6 muajsh, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të nxjerrë aktet nënligjore me qëllim që ligji të mos presë si kur në rastin që e përmendi zotëria atje, juristi i nderuar, për pesë vite ndoshta në Shqipëri që nuk ka efekt ligji, por ligji të marrë një formë efektshmërie dhe të rregullojë në atë masë sa është e rregullueshme kjo fushë.

Ne e dimë që shumica e vendeve evropiane ende kanë vështirësi në adresimin e çështjeve që lidhen me krypto-asetet, e lëre më Kosova, mirëpo ne si deputetë e kemi ndier përgjegjësinë e lartë që kemi në vend, që sidomos pjesa e këmbimoreve që e kemi parë që po lulëzojnë në vendin tonë, të kenë një trajtim nga aspekti ligjor dhe të kenë një rregullim sa i takon operimit të tyre.

Në këtë drejtim mendoj që ligji përbën një hap pozitiv drejt, le të themi, rregullimit të fushës së krypto-aseteve dhe mua më gëzon fakti që Banka Qendrore e Kosovës si autoritet që e ka kuptuar që do të jetë autoriteti kryesor për licencim dhe autorizim të operatorëve e ka marrë për obligim që qysh ende pa kaluar ligji në lexim të dytë, të fillojë të ndajë resurse, t'i mendojë ndoshta edhe aktet nënligjore t'i draftojë me qëllim që të eci shpejtë dhe të mos zbrazëtira dhe vonesa sa i takon implementimit të ligjit.

Konsideroj që një rol të rëndësishëm do të ketë edhe njësia e inteligjencës financiare. Nëse veç i kemi prezentë këtu, kisha pasur dëshirë të shoh edhe të dëgjojmë edhe prej tyre sa i takon pjesës së monitorimit, qoftë të manipulimeve, qoftë të lëvizjeve, transaksioneve, sa do të jenë në gatishmëri që ta mbështesin implementimin e ligjit, sepse në fund të fundit, ne si deputetë, si Kuvend e miratojmë ligjin, por kemi shumë instanca të tjera, shumë autoritete të tjera të cilat do të jenë bartës dhe implementues të ligjit, e që më vonë ne si deputetë do të futemi në monitorim dhe të shohim sa ka qenë efektshmëria dhe zbatimi i ligjit.

Mirëpo, mendoj që duhet të jemi bashkë në këtë sfidë, për arsye se tregu ka nevojë për t'u rregulluar se shumë qytetarë, qoftë bëjnë transaksione, qoftë kanë investuar në krypto-asete dhe mendoj që kemi përgjegjësinë që për aq sa është e mundur kjo fushë të rregullohet, ta bëjmë.

E tha edhe kryesuesja që ne kemi kaluar nëpër një procedurë jashtëzakonisht të gjatë të trajtimit të çështjes së krypto-aseteve, por edhe duke i marrë edhe praktikën më të mira ndërkombëtare të financuara nga vet Këshilli i Evropës përmes dy ekspertëve që i kemi ftuar këtu, por pa anashkaluar edhe punën që e ka bërë juristi Virtyt në draftimin e projektligjit fillestar që e kemi pasur e që mandej është plotësuar, e që besoj edhe ky projektligj që e kemi sot në dorë e që mund

ta trajtojmë nen për nen sipas praktikës parlamentare mund ta plotësojmë edhe duke marrë ndonjë referencë nga projektligji fillestar që ka qenë dhe ta kemi një legjislacion tamam për aq sa është mundur të rregullohet kjo fushë.

Po e përmendi që disa herë, sepse edhe vendet më të zhvilluara edhe në ato ku ka lulëzuar vet fusha dhe sektori i krypto-aseteve ende ballafaqohen me sfida edhe me befasi të ndryshme. Mirëpo, mendoj që si deputet e kemi obligim ndaj qytetarëve të cilët kanë investuar, të cilët tregtojnë me to, ndaj operatorëve të cilët janë duke e bërë këtë veprimtari, të jemi të përgjegjshëm, të kemi legjislacion dhe në fund të fundit, ata që tregtojnë, ata që përfitojnë shumë edhe të kenë obligimet e tyre ndaj autoriteteve në vend për të paguar edhe ato tatime të cilat janë të parashikuara me ligjet dhe procedurat në vend. Ju faleminderit edhe njëherë!

KRYESUESJA: A do dikush tjetër prej pjesëmarrësve ta marrë fjalën? Njësia e Inteligjencës Financiare, po nëse s'gaboj apo jo. Po.

ARSIM FEJZULLAHU: Siç shihet projektligj çdo bartës i licencës ose autorizimit konsiderohet si subjekt raportues edhe në Njësinë e Inteligjencës Financiare. Domethënë, futet te subjektet e tjera raportuese në bazë të Ligjit të parandalimit të pastrimit të parave dhe i obligohet gjitha detyrimeve që dalin nga Ligji i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit...që rregullohet me udhëzimet administrative dhe aktet nënligjore.

D.m.th. si në subjektet e tjera edhe këtu do të bëhet monitorimi dhe mbikëqyrja e subjekteve të cilat merren me asetet...

KRYESUESJA: Faleminderit! Dikush tjetër?

VALON THAÇI: Përshëndetje! Jam Valon Thaçi prej kompanisë “Caktus” së bashku me Nitin. Është një kombinim interesant, por pikë së pari ju falënderoj shumë për ftesën, për angazhimin të gjithëve. Faleminderit, zoti avokat edhe juve të pranishëm!

Do të thotë, gjithmonë e kem atë hallin se si do të funksionojnë këto farë kriptovalutat. Njëjtë sikurse që e kemi....nuk e di a kemi në sistemet financiare ekziston edhe një modul edhe një mundësi ta kemi njëjtë për kriptovalutat.

Ekzistojnë kompani të ndryshme të cilat e bëjnë përcjelljen edhe monitorimin. Për sa u përket aspekteve ligjore se si do të funksionojnë është më përgjegjës zotëria këtu përballë. Sa i përket tjetër këndeje te ne, ne do t'i shtojmë ato pjesët e nevojshme sipas kërkesës që ju ma adresuat.

Do të thotë, nëse ekziston mundësia që të kemi siç janë kompanitë është një kompani shumë e njohur angleze e cila është gjithashtu është një kohë të gjatë duke punuar në këtë drejtim. E ka

krijuar platformën si për investigimin financiar, njëjtë e ka krijuar një platformë për këtë pjesë. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Dikush tjetër? Urdhëroni!

ARIANIT DURAKU: Thënë të drejtën kur unë kam folur para shumë për...nëpër kompaninë “Caktus” se kam shumë vite në “Kaktus”, edhe me një ish-drejtor të FMN-së që e kam pasur shok të ngushtë që nuk është sot në Kosovë, njerëzit më kanë parë shtrembër dhe më kanë thënë, po flet ky, por çfarë po flet.

Jemi në pikën ku ndryshimi i madh është duke ardhur edhe besoj që të gjithë njohësit e mirë të kriptu-aseteve të... të mënyrës si operojnë, besoj që duhet me qenë, me bo një unit për ta bërë një draftim të një ligji, jo vetëm të mbrojë interesat shtetërore, por edhe të mbrojë edhe interesat personale të njerëzve, sepse ka shumë mashtrime, ka shumë zhvatje, ka shumë gjëra të cilat janë të paligjshme.

Ideja është të mbërrimë deri te pika, do të vijmë te pika deshëm s’deshëm ne, ku sistemi i...gradualisht do zhvendoset sistemet bankare sot. Jemi duke shkuar drejt asaj pune. Ne duhet të jemi elitarët e një mase, e një populli që ende nuk di të hap një aplikacion të thjeshtë në telefon, e jo të detyrohem unë ta hap një Exchange akont, të bëjmë transaksione që do të vijmë në këtë pikë.

Unë po besoj që është më e udhës një herë të nisim ta bëjmë një sensibilizim të masës. Të shohim mënyrën se sa do ta kuptojë masa këtë ndryshim që po vjen, sepse është duke ardhur. Edhe të ulemi e të shohim rregullative se si do të funksionojë, prapë unë po dal te licenca se është një akt shumë i mirë, por është shumë i vështirë për implementim. Sot, ka të drejtën secili në telefon të vetin të bëjë transaksione.

Dhe, në qoftë se nuk mbërrimë te ai niveli si një shtet të bëjë marrëveshje me institucionet ndërkombëtare për pranimin e shtetit s’ke si e monitoron dhe s’ke si operon. Legalisht po flas unë. Besoj që fola shumë!

KRYESUESJA: Pa problem, vetëm që ta keni parasysh se ju e përmendet një njësi, ne prej gushtit të vitit 2021 jemi duke e trajtuar edhe nuk është proces që ka mbetur i mbyllur. Ka qenë proces që janë ftuar gjithmonë palët. Gjithmonë që ka shkuar me njoftime publike, që kemi marrë komente, por ndoshta jo shpesh edhe gatishmëri të njerëzve t’i dedikohen kësaj çështjeje.

Unë e kuptoj edhe industrinë, se natyrisht koha është para edhe angazhohen me punët e veta. Punë legjislative janë të Kuvendit, por që ideja nuk ka qenë me e vendos siç e thashë që në fillim, e po e ripërsëris, shtetin mbi ata që përfitojnë në kuptimin veç të marrjes së taksave, por

çka janë metodat ose mënyrat për ta stimuluar edhe investimin, po gjithmonë duke e pasur parasysh që bëhet investim i rregullt dhe natyrisht transparent, e jo investim që pastaj mund të përdoret për financim të aktiviteteve të tjera.

Në cilindo rast, unë po ju inkurajoj që ato vlerësime apo rekomandime që i keni në raport me draftin që është para jush. Ky draft ka kaluar një lexim në Kuvend. D.m.th. ka marrë miratimin e përfaqësuesve të shumicës së Kuvendit të Republikës dhe tash është procesi mes dy leximeve që prapë ne e kemi këtë diskutim të hapur bashkë.

Drafti është gjithashtu online në faqen e Kuvendit, në momentin kur miratohen, prej momentit kur vijnë prej Qeverisë, ato publikohen dhe janë aty për të gjithë që dëshirojnë t'i shohin ose të gjithë që dëshirojnë t'u referohen.

Dhe, mandej të njëjtat mund të na i dërgoni. Afatin e dërgimit të komenteve në draftin aktual e keni një javë, deri më 27 qershor, do të thotë një javë nga dita e sotme, pas të cilit proces, ne pastaj si grup punues takohemi dhe i shqyrtojmë nen për nen edhe me institucionet e tjera që janë të interesuara të jenë pjesë.

Që ta dini, për informatë, sy ekspertë që kanë qenë nga Këshilli i Evropës janë: Samanta Shin dhe Ejdo Larkin. Që të dy janë me angazhim të gjatë, e në veçanti Samanta e cila ka qenë në aspektin profesional e angazhuar në risk menagment në parandalimin e krimeve financiare përmbi 15 vjet.

D.m.th ideja dhe angazhimi edhe i tyre, por edhe interesimi i Këshillit të Evropës, pas Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, NJFI-it, Inteligjencës Financiare ka qenë që të kemi projektligj që është në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare, por natyrisht që nuk e ngufat iniciativën private, gjegjësisht ndërmarrësit të jenë të angazhuar, të jenë kreativë e natyrisht edhe të krijojnë fitim.

Nëse nuk ka komente të tjera në raport me projektligjin, unë do ta mbyllja takimin, gjithmonë duke ju falënderuar për kohën, pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj, por edhe duke ju inkurajuar që të jeni të angazhuar në çka do që ju që mendoni që mund ta bëjmë këtë projektligj më të mirë, e më vonë edhe si ligj të zbatueshëm.

Ju faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*